



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 914  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
TIRANË

NR. VENDIMI 3629

NR. 914 AKTI  
NR. 3629 VENDIMI

V E N D I M

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga:

GJYQTARI ALTIN SHKURTI

Asistuar prej sekretares gjyqësore Suela Arapi (Murataj) në Tiranë sot me datë 21.09.2020, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore publike çështjen civile me Nr. 914 Akti që i përket.

PADITES: \*\*\*, e bija e \*\*\*, e datelindjes \*\*\*, e lindur dhe banuese ne \*\*\*, \*\*\*, me perfaqesues ligjor \*\*\*dhe \*\*\*, te perfaqësuar me prokure te posacme nga zyra e avokatise \*\*\*, perfaqësuar ne gjykim nga Av. \*\*\* dhe/ose Av. \*\*\*, me adrese rruga \*\*\*.

I PADITUR: Shoqeria \*\*\*\*, pajisur me (NIPT) \*\*\*, me seli ne adresen \*\*\*, me administrator \*\*\*, përfaqësuar në gjykim nga Av. \*\*\*.

PERSON I TRETË: Shoqeria \*\*\*\*, pajisur me (NIPT) \*\*\*, me seli ne adresen, \*\*\*, perfaqesuar nga administratori i saj z. \*\*\* (në mungesë)

OBJEKTI: Konstatimi i cenimit nga pala e paditur Shoqeria \*\*\*\*" sh.p.k. te se drejtes pasurore dhe jopasurore te paditeses \*\*\*, ne rolin e interpretueses ne veper (reklame), Detyrimin e pales se paditur qe ti paguaj nje shperblim te drejte paditeses, ne rolin e interpretuese ne vepren (reklama), ne kushtet e perfitimit nga të drejtat ekskluzive pasurore dhe jopasurore te saj ne vleren e \*\*\* leke.

Detyrimin e te paditurve te paguajne shpenzimet gjyqesore.

BAZA LIGJORE: Nenet 8, i K.Civil; neni 107, 108, 109, 27, 29, 31, 172, 174 te Ligjit Nr. 35/2016 "Per te Drejten e Autorit" nenet 31, 32, 91, 126, 154/a, i K.Pr.Civil.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e kërkesë- padisë, i padituri që kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë dhe personin e tretë që e la gjykimin në mungesë dhe shqyrtoi çështjen në tërësi

VËREN:

Paditësja \*\*\* i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi me objekt konstatimi i cenimit nga pala e paditur Shoqeria \*\*\*\*" shpk te se drejtes pasurore dhe

jopasurore te paditeses \*\*\*, ne rolin e interpretueses ne veper (reklame). Detyrimin e pales se paditur qe ti paguaj nje shperblim te drejte paditeses, ne rolin e interpretuese ne veperen (reklama), ne kushtet e perfitimit nga të drejtat ekskluzive pasurore dhe jopasurore te saj ne vleren e \*\*\*leke.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes rezultoi e provuar se:

#### Rrethanat e faktit

Shoqeria "\*\*\*\*" sh.p.k. eshte nje shoqeri e regjistruar ne QKB me numrin unik NUIS \*\*\*. Kryen aktivitet ne fushen e reklamave, veprave audiovizuale, sherbime audiovizuale etj (vertetuar nga ekstrakti i QKB). Ajo gjithashtu administron dhe faqen e internetit \*\*\*, ne te cilen publikohen punimet e kryera prej kesaj shoqerie.

Pala paditese \*\*\*, ne daten \*\*\*, ka kryer me sukses xhirimet e spotit. Pavarësisht se keto xhirime jane kryer me sukses, nuk rezulton qe pala e paditur, shoqeria \*\*\*, ne cilesine e prodhuesit te spotit, ti kete ofruar per nenshkrim paditeses kontraten e prodhimit; kontrate kjo ne te cilen do te percaktoheshin te drejtat pasurore qe i kalonin prodhuesit te spotit, afati i kalimit te ketyre te drejtave, shperblimi perkates edhe element te tjere te rendesishem te cilet do te definonin marredhenien juridike midis paleve ndergjyqese.

#### Pretendimet e palëve

##### Pretendimet e paditësit

Paditësja \*\*\* pretendon se formalizimi i marredhenies nepermjet nje kontrate shkresore parashikohet si detyrim ligjor ne nenet 109.6, 5.2, 103.2, 103.4 dhe 48 te ligjit 35/2016. Madje nje marreveshje e tille duhej regjistruar dhe certifikuar edhe ne Drejtorine per te Drejtat e Autorit sipas nenit 103.4 te ligjit.

Ne analize te neneve te sipercituara, konkludojme se formalizimi i marredhenies juridike nepermjet nje kontrate shkresore prodhimi perben kusht ligjor per vlefshmerine e vete marredhenies. Ne kushtet kur nje kontrate e tille mungon (nuk eshte nenshkruar) - atehere - edhe marredhenia juridike midis paleve ndergjyqese konsiderohet te jete e paqene, inekzistente (per shkak te pavlefshmerise absolute). Per kete, edhe shfrytezimi i te drejtave pasurore te interpretimit/ekzekutimit (shitja, qiradhenja ose huaperdorja ne favor te personave te trete) nga shoqeria \*\*\* sh.p.k. dhe transmetimi e percjellja ne publik e interpretimit/ekzekutimit nga shoqeria \*\*\* sh.a jane teresisht te paligjshme. Kjo pra, pasi mungon autorizimi i paditeses (sipas formes se kerkuar nga ligji) per shfrytezimin e interpretimit/ ekzekutimit. Eshte pikerisht mungesa e ketij autorizimi ajo cka passjell edhe cenimin e te drejtave ekskluzive te paditeses, te tilla si e drejta per shperndarjen e interpretimit/ ekzekutimit, e drejta per ta dhene me qira ose huadhenie etj... Keto te drejta sipas nenit 109 te ligjit 36/2015 jane te drejta qe i perkasin ekskluzivisht pales paditese ne cilesine e interpretueses/ekzekutueses dhe i kalojne prodhuesit vetem permes nje kontrate shkresore prodhimi.

Lidhur me sa siper, ne piken 8 te deklarates se mbrojtjes, i padituri prapson se marreveshja ne rastin konkret eshte formalizuar ne menyre verbale midis paleve ndergjyqese (persa i perket cmimit apo kushteve te tjera) dhe se nenshkrimi i saj eshte konsideruar formalitet nga prinderit e paditeses. Mosnenshkrimi i kesaj kontrate sipas te paditurit nuk u arrit per arsye objektive qe lidhen me paditesen. Po ashtu, sipas te paditurit paditesja e ka dhene autorizimin, e ka shprehur vullnetin e saj per ekzistencen e marredhenies juridike nepermjet veprimeve konkludente. Theksojme se keto prapsime te paditurit jane sa abuzive aq edhe te paverteta. Kjo pasi pikese pari detyrimi ligjor per te formalizuar marredhenien juridike

ndermjet paleve, nepermjet nje kontrate prodhimi/punesimi/porosie etj, i takon te paditurit si personi juridik i cili ka prodhuar spotin (nenet 674 e 675 te K.C). Pikesedyti, edhe nese do ta pranojme si te provuar vullnetin e shprehur nga paditesja apo gjyshja e saj, ky vullneti eshte teresisht i parendesishem per ligjin. Kjo pasi padltesja ne kohen e realizimit te spotit ka qene nen moshen 14 vjec dhe per rrjedhoje, cdo veprim juridik ne te cilen ajo eshte pale, referuar neneve 216, 221, 222 dhe 232 te K.F ne lidhje me nenin 8 te K.C, mund te kryhet vetem nepermjet prinderve te saj si perfaqesues ligjor te vetem te te mitures, deri ne arrijten e moshes madhore. Pikesetreti formalizimi i kesaj marredhenieje nepermjet nje akti shkresor, kontrate, perben kusht ligjor per vlefshmerine dhe provueshmerine e marredhenies juridike (nenet 5.2, 103.2, 109.6, 48 dhe 103.4 te ligjit 35/2016).

Ne kushtet kur gjate hetimit gjvqesor rezultoi e provuar se paditesja ka realizuar me sukses xhirimet e spotit; ndersa i padituri, per sa siper cituar, i ka shfrytezuar ne menyre te paligjshme te drejtat pasurore te pales paditese per kete veper, madje duke ia kaluar ato po ne menyre te paligjshme shoqerise \*\*\* sh.a - atehere - vleresojme se paditesja legjitimohet plotesisht per te kerkuar shperblimin e demit per perdorimin e paautorizuar te interpretimit/ekzekutimit nga pala e paditur. Madje theksojme se veprime te tilla jane parashikuar edhe si kundravajtje nga germa gj) e nenit 179 te ligjit 35/2016, per te cilat pika 2 dhe 3 e ketij neni parashikon nje gjobe nga 100.000 deri ne 500.000 leke. Ndersa pika 6 e nenit 179 te ligjit parashikon se ndaj personit juridik, i cili kryen shkeljet mund te ndermerret masa e ndalimit te kryerjes se aktiviteteteve tregtare per nje periudhe prej 1 viti.

Se dyti, pala e paditur prapëson ne deklarate mbrojtje se kerkese-padia duhet rrezuar pasi nga provat dhe faktet e sjella nga i padituri rezulton e provuar qe paditesja ka shprehur pelqimin e saj per shfrytezimin e interpretimit/ekzekutimit nga i padituri. Pra, paditesja ka qene dakort per ekzistencen e marredhenies juridike midis paleve ndergjyqese.

Lidhur me kete prapsim parashtrrojme se - vec faktit qe ne rastin konkret marredhenia juridike midis paleve ndergjyqese eshte obskure, ne kuptimin qe nuk arrihet te identifikohet nese palet kane qene ne nje marredhenie punesimi, porosie apo pales paditur keto te drejta jane dhene me qira ose huaperdorje - perben fakt te pakontestuar qe padltesja ka marre pjese ne xhirimet e spotit dhe se keto xhirime jane shfrytezuar per interesa tregtar nga shoqeria \*\*\* sh.p.k.

Ne kushtet kur paditesja ka realizuar me sukses xhirimet e spotit dhe keto xhirime jane shfrytezuar nga pala e paditur - nuk ka asnje ekuivok qe - kjo e fundit detyrohet te shperblejne paditesen ne perputhje me nenin 109 te ligjit 35/2016.

Per kete shkak, edhe sikur ta marrim te mireqene faktin qe paditesja ka shprehur vullnetin e saj per kalimin e te drejtave ekonomike ne favor te shoqerise \*\*\* sh.p.k - serisht - ky kalim behet ne cdo rast kundrejt nje shperblimi te drejte sipas pikes 7 te nenin te sipercituar dhe neneve 103.2 dhe 20.2 te ligjit 35/2016 dhe ne asnje rast pa shperblim. Ndaj edhe prapësimi i pales paditur qe kerkese-padia duhet te rrezohet eshte absurd dhe kontradiktor me faktet e pohuara nga vete kjo pale dhe me provat e depozituara ne gjykate.

Se treti, persa i perket te drejtes se shperblimit te pales paditese lidhur me interpretimin e saj ne spotin e xhiruar nga pala e paditur ai bazohet ne nenet 163.1, 109, 103.2, 5.2 ne lidhje me nenin 49 dhe 172 te ligjit 35/2016.

Neni 172 parashikon se "Ne qofte se nje e drejte, sipas ketij ligji, eshte shkelur qellimisht ose nga pakujdesia e rende, titullari i se drejtes mund te kerkoje pagimin, per te cilin eshte rene dakord ndermjet tyre, ose shperblimin perkates per kete perdorim nga personi, i cili ka shkelur te drejten e tij, povaresisht nese ai ka pesuar demtime per shkak te kesaj shkeljeje".

Ne rastin konkret rezulton se shkelja e kryer nga pala e paditur eshte ne formen e pakujdesise se rende. Keshtu, si faj ne fomen e pakujdesise se lehte do te konsiderohen rastet kur subjektet nuk tregojne perkujdesjen e zakonshme ne kryerjen e veprimeve; ndersa si faj ne formen e pakujdesise se rende do te konsiderohen rastet kur subjektet nuk tregojne perkujdesjen minimale ne kryerjen e veprimeve. Por ne rastet e profesionisteve, sic eshte i

padituri, edhe ne rastet kur subjektet nuk tregojne perkujdesjen e zakonshme, forma e fajit do te konsiderohet si pakujdesi e rende (dhe jo si pakujdesi e lehte). Kjo pikerisht per shkak te cilesive e aftesive te shtuara qe profesionistet kane ne raport me te tretet. Per shkak te ketyre cilesive e aftesive mbi to rendon detyrimi per te treguar nje perkujdesje me te lart se personat e tjere. Ne te njejten fryme eshte edhe parashikimi i nenit 675 te K.C.

Ne vazhden e ketij arsyetimi, theksojme se veprimet e pales paditur \*\*\* sh.p.k. jane te tilla qe kane pervetesuar arbitrarisht te drejtat pasurore te pales paditese per interpretimin/ekzekutimin e kryer. Themi pervetesuar arbitrarisht pasi nuk rezulton qe i padituri te kete formalizuar marredhenien e tij me paditesen nepermjet ndonje kontrate shkresore. Per me teper qe paditesja ne rastin konkret ka qene e mitur, nen moshen 14 vjec. Po ashtu, duke vepruar arbitrarisht dhe njeanshmerisht, i padituri praktikisht i ka kufizuar lirinë e vullnetit paditëses lidhur me kushtet e kontratës së prodhimit, e konkretisht i imponon asaj kushte të tilla si vlera e shpërblimit për interpretimin/ekzekutimin e kryer (duke marrë për referencë vlerat e paguara për interpretuesit/ekzekutuesit e tjerë në rekalma të ngjashme), të drejtat pasurore të kaluara (në kushtet kur nuk ekziston një kontratë e shkruar, atëherë pala e paditur prezumon kalimin e të gjithë të drejtave pasurore në favor të saj, sipas nenit 109.6 etj. Gjithashtu obscure mbetet edhe situatë lidhur me të drejtat e tjera pasurore të evidentuara në nenin 109.1, kohëzgjatja e transferimit të tyre etj..

Per kete shkak, ne veshtrim te nenit 172 te ligjit 35/2016, pala paditese ka te drejten te kerkoje nga pala e paditur - ose - shperblimin perkates te demit per perdorlim te paautorizuar te interpretimit/ekzekutimit - ose - shumen e dakordesuar midis paleve - ose - shperblimin per perdorim legjitim te asaj vepre. Duke pasur ne konsiderate permbajtjen e kesaj dispozite por edhe rrethanat konkrete te faktit si me siper cituar, pala paditese, ne disponim te se drejtes se saj, kerkon nga pala e paditur ti shperbleje demin perkates per perdorim te paautorizuar te interpretimit/ekzekutimit.

Lidhur me vleren e shperblimit, nenet 109, 49 dhe 172 te ligjit 35/2016 parashikojne parimin e shperblimit te drejte dhe te plote te demit.

Vlera prej \*\*\* leke (te reja) e kerkuar nga pala paditese ne objekt padie perputhet plotesisht me kete parim. Kjo vlere nuk perfaqeson nje vlere pasurimi per palen paditese, porse ajo eshte ne perputhje me parimin e shperblimit te plote te demit, i cili synon rivendosjen e paditesit ne gjendjen e meparshme ne te cilen ai do te gjendej sikur te mos kishte ndodhur fakti i palilgjshe, jo vetem ne kuptimin e ngushte ekonomik, por edhe ne te mirat jopasurore qe meshirojne vlerat e njeriut. Ne kete aspekt sjellim ne vemendje se paditesja eshte e mitur. Gjithashtu, kjo vlere eshte ne perputhje edhe me parimin e shperblimit te drejte dhe objektiv (koherent) te demit, qe nenkupton shperblimin e demit ne menyre te plote dhe te menjehershme ne te holla. Nje tjeter aspekt i rendesishem ne percaktimin e vleres eshte edhe faji dhe forma e shkaktimit te tij; ku ne rastin konkret nga pala e paditur eshte vepruar me keqbesim (pakujdesi e rend), e cila pa informuar paditesen, pa nenshkruar kontrate dhe pa autrozimin e paditeses vijoj me shfrytezimin e interpretimit. Per me teper qe edhe sot pas nje viti serisht nga pala e paditur nuk eshte kryer asnje veprim konkret per te korigjuar veprimet e paligjshe, e me konkretisht nuk njoftuar ne asnje rast paditesja mbi shfrytezimin e interpretimit dhe aq me pak nuk eshte vepruar per tu paguar paditesja. Thkesojme se sa me i rend te jete fakti i paligjshe aq me i madh dote jete shperblimi i demit.

Te njejtat element si siper cituam duhen pasur ne konsiderate edhe referuar pikes 4 te nenit 172 te ligjit 35/2016. Sjellim ne vemendje se shperblimi i marre nga shoqeria \*\*\* sh.p.k per spotin e realizuar eshte ne nje shume totale prej \*\*\* leke. Sipas pohimeve te tyre ne deklarate mbrojtje, shuma me te cilen jane shperblyer 22 interpretuesit e tjere eshte ne nje total prej \*\*\* leke, Kjo shume perben vetem \*\*\* % te shumes totale te perfituruar nga shoqeria \*\*\* sh.p.k per realizmin e spotit. Ndersa shuma e perfituruar nga secili interpretues perben vetem \*\*\* % te shumes totale te pefituruar nga shoqeria \*\*\* sh.p.k. Vleresojme se keto shuma jo vetem qe nuk

jane ne perputhje me parimin e shperblimit te drejte te sanksionuar ne nenin 109 te ligjit por perkundrazi jane abuzive dhe qesharake. Per kete shkak, vlerat e referuara nga pala e paditur se nje interpretues merr nje shperblim prej \*\*\* leke (te reja) kurresesi nuk mund te pranohen nga pala paditese. Kete qendrim te saj pala paditese nuke ka shprehur vetem gjate ketij gjykimi por edhe gjate kohes se provave per realizmin e spotit si dhe gjate xhirimeve; dhe se nga pala e paditur u dakortesua qe kjo vlere shperblimi nuk eshte e drejte per sa siper dhe se pales paditese do ti ofrohej nje vlere ne perputhje me parimet e sipercituara. Ne vazhdim nga pala e paditur eshte propozuar vlere prej \*\*\* Euro e cila - serisht - per sa siper, nuk u pranuar nga pala paditese. Sakaq, cmojme te evidentojme se nese shperblimi ne vleren e pretenduar ne deklaraten e mbrojtjes nga pala e paditur prej \*\*\* te reja do te ishte nje shperblim i drejte - ate here - nuk do te kishte asnje arsye apo shkak ligjor se perse vete kjo pale ti propozonte paditese shumen prej \*\*\* Euro si shperblim per interpretimin e kryer. Madje ky propozim tregon edhe keqbesimin e pales paditur ne perpjekjet e saj per te mashtruar paditesen lidhur me masen e shperblimit, duke pretenduar se vlere prej \*\*\* leke te reja aplikohet edhe ndaj interpretuesve te tjere. Per pasoje, per sa siper cituam, gjykata, ne perputhje me piken 4 te nenit 172 te ligjit, duhet te kete ne konsiderate edhe shperblimin e marre nga shoqeria \*\*\* sh.p.k nga perdorlmi legjitim i vepres (shprndarjen ne favor te shoqerise \*\*\* sh.a). Sic cituam me siper, shperblimi i marre nga perdorlmi legjitim i vepres eshte element i rendesishem edhe refuar nenit 109 te ligjit 35/2016, sipas te cilit shperblimi perbehet nga shperblimi i perfitur nga shoqeria \*\*\* sh.p.k, marre nga shoqeria \*\*\* sh.a, dhe qe i perket interpretuesve/ ekzekutuesve.

Po ashtu nje aspekt i rendesishem ne percaktimin e shperblimit te drejte eshte edhe gjeresia e shperndarjes ne TV, rrjete sociale apo billboardet e intepretimimit te paditese por edhe imazhit te saj. Konkretisht, evidentojme se interpretimi prove eshte shfaqur ne formen e nje reklame ne televizione me shikueshmeri shume te larte (Klan, Top Channel etj ...); interpretimi eshte shfaqur si reklame per nje periudhe mbi 6 mujore; reklama eshte shfaqur edhe ne rrjete sociale te tilla si facebook etj... Gjithashtu, interpretimi i paditese nuk eshte shfaqur vetem ne formen e nje reklame por edhe te nje imazhi (fotografie) ne billboardet te ndryshme dhe ne vecanti ne aeroportin e Rinasit (vend i cili ka nje shikueshmeri shume te larte nga publiku) dhe Portin e Duresit etj...

Sakaq, legjislacioni ne fuqi qe rregullon kompensimin e demeve te shkaktuara eshte K.C, i cili ne nenet 608 e vijues parashikon kushtet e ekzistences se demit jashtekontraktor. Duke qene se veprimet e pales paditur shoqeria \*\*\* sh.p.k jane teresisht te paligjshme, atehere, vec sa siper pala paditese eshte cenuar rend ne nje ser te drejtash jopasurore personale. Per kete shkak, vleresojme se ne rastin konkret konsumuar te gjithë elementet perberes te pergjegjesise jashtekontraktore, sikurse jane 1) Fakti paligjshem 2) Faji 3) Demi dhe 4) Lidhja shkaksore.

Persa i perket demit, cmojme se nje nder parimet themelore te bashkejeteses ne shoqeri eshte ndalimi per ti shkaktuar tjetrit dem. Zbatimi i ketij parimi gjen zbatim ne nenin 608 te Kodit Civil. Ne baze te kesaj pergjegjesie, e njohur si pergjegjesia akuifane (lex Aquilia de damno), cilido qe shkel te drejtat dhe interesat e ligjshme te nje tjetri detyrohet t'a demshperbleje ate. Nepermjet demshperblimit synohet pikerisht rivendosja e plote e te demtuarit (restitutio in integrum) ne gjendjen e meparshme (status quo ante), ne te cilen ai do te gjendej nese nuk ndodhte fakti i paligjshem, jo vetem ne kuptimin e ngushte ekonomik, por edhe ne te mirat jopasurore qe mishërojnë vlerat e njeriut. Lidhur me masen e demit, sjellim ne vemendje te gjykates se argumentat ligjor te pales paditese jane parashtruar nga paragrafi 23 - 30 te ketyre shpjegimeve.

Persa i perket lidhjes shkaksore, nuk ka asnje ekuiwok qe veprimet e pales se paditur i kane mohuar pales paditese te drejten per shperblim; fakt ky i pakontestuar gjyqesisht e jashtgjyqesisht edhe nga pala e paditur. Madje kjo e fundit per me teper eshte pasuruar nga

keto veprime.

Ne konkluzion te sa siper, ne kushtet kur midis paleve ndergjyqese nuk ka ekzistuar asnje marredhenie kontraktore e formalizuar, pala paditese legjitimohet te kerkoje vleren e plotë te shperblimit qe ajo duhet te perfitoje per interpretimin/ekzekutimin e saj. Per kete shkak, gjykata duhet te detyroje palen e paditur te shperbleje palen paditese ne nje vlere totale prej \*\*\* leke (te reja).

Se pesti, me vendim te ndermjet gjykata ka vendosur te therrase ne cilesine e deshmitarit personat e thirrur nga i padituri. Lidhur me theniet e tyre si mjet provues, paditesja kerkon qe ato te mos administrohen si prova nga gjykata ose ne te kundert, te mbeten pa fuqi ligjore. Kjo pasi prova me deshmitare qe te pranohet si e tille duhet te jete e trete qofte ne raport me faktin apo qofte ne raport me palet (per efekt besueshmerie dhe vertetsie). Nuk rezulton qe personat te cilet deshmuuan ne proces te ishin te trete ne raport me palet. Konkretisht nga pergjigjet e dhena ato rezultuan te kishin marredhenie te posacme me te paditurin. Shtetasi \*\*\* pohoi te kishte qene ne marredhenie punesimi me te paditurin si dhe te kishte shoqeri me drejtuesit e shoqerise (madje administrator tentoi ta njoftonte edhe me cel shtetasin ne fjale gjate seances gjyqesore): ndersa shtetesja \*\*\* rezultoi te ishte nena e shtetasit \*\*\*. Po ashtu, nga te dy keto shtetas u pohua se ato jane njoftuar nga i padituri si persa i perket dates dhe ores se gjykimit ashtu edhe persa i perket ceshtjes per te cilen ato do deshmonin. Madje u pohua nga shtetesja \*\*\* se ajo kishte komunikuar e diskutuar paraprakisht e me djalin e saj \*\*\* lidhur me deshmine: ndersa djali e mohoi kete fakt ne deshmine e tij (cka i bene theniet e tyre kontradiktore ne kete aspekt.

Per me teper qe referuar nenit 231 te K.Pr.C eshte e ndaluar prova me deshmitar per ato veprime juridike per te cilat ligji kerkon forme shkresore per efekt vlefshmerie por edhe provueshmerie: sikunder eshte edhe kontrata e prodhimit e cila duhet te formalizonte marredhenien juridike mes paleve. Kështu që padia duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.

### Prapësimit e të paditurit

I padituri prapëosi se \*\*\* njihet me familjen e paditeses \*\*\* nepermjet nje lidhjeje shoqerore e familjare qe ish punonjesi i \*\*\* z. \*\*\* ka me kete familje.

I padituri prapëosi se nga faktet qe provohen ne kete gjykim dhe rrjedha e ngjarjeve midis paleve ndergjyqëse kuptohet qarte se padia eshte e pabazuar ne ligj e ne prova. Nuk provohet perdorimi i paatorizuar i interpretimit apo kinoproves se paditeses. Pretendimet per dem qe rrjedh nga te drejtat e saj si interpretuese e reklames, i ndare ky ne dem pasuror dhe jopasuror jane te pabazuara ne ligj. Paditesja ngaterron qellimisht shperblimin e demit te pretenduar, dhe shperblimin e qe perfitonte paditesja nga te drejtat ekskluzive pasurore dhe jo pasurore te interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit (sic pretendon se eshte paditesja) qe garantohen nga Ligji 35/2016 "Per te Drejtat e Autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me to".

Faktet e mesiperme u provuan ne menyre te plote edhe nga akti i ekspertimit te numrave telefonik mbi komunikimet e prinderve te paditeses dhe perfaqesuesve te te paditurit, por edhe profesionisteve qe moren pjese ne realizimin e spotit objekt gjykimi. Ne kete linje ishin edhe deshmitare e dy deshmitareve qe kishin njohje per rrethanat e ceshtjes: zj. \*\*\* dhe z. \*\*\*. Paditesja e ka dhene pelqimin e saj per realizimin e spotit televiziv (materialit audioviziv) me veprime konkludente. Paditesja ka nje argument te vetem ku e bazon demshperblimin e kerkuar. Ky argument eshte mosekzistenca e kontrates se shkuar midis paleve. Por ne faktet e paraqitura me lart eshte e qarte se paditesja dhe perfaqesuesit e saj ligjor nuk e kane penguar asnjehere vajzen te marre pjese ne sport, te kryeje xhirimet e tij dhe te jete e kenaqur me kushtet e ofruara nga i padituri per kete marredhenie, ka shfaqur vete por edhe prinderit e saj deshiren per tu shfaqur sa me shpesh, si spotin objekt gjykimi, ashtu edhe ne cdo spoti tjetër

te mundshem. Nuk ka si shpjegohen ndryshe veprimet e paditeses ne marrjen pjese ne proceset e prodhimit te spotit audioviziv sic jane provat dhe xhirimet te cilat ajo nuk permend ne padi. Po ashtu edhe marredhenia e me vonshme ku paditesja ka marre pjese ne nje spot te dyte per te cilin nuk shprehet ne padi, por konsesnusi i saj heshtur dhe pjesemarrja vullnetarisht ne nje spot te dyte tregojne se ajo ka qene e vetedishme per pjesemarrjen ne spot, me te nejtat kushte si edhe gjithe figurantet e tjere ne kete spot dhe ka shprehur deshiren dhe vullnetin per tu shfaqur sa me shpesh. Jo vetem kaq, por eshte ofruar edhe per nje spot te dyte, pas disa muajsh ku ka ardhur se bashku me mete emen dhe gjyshen, duke u here ajo dhe gjyshja pjese e spotit te dyte.

Referuar te drejtes sone materiale, kontrata si veprim juridik, nenkupton shprehjen e vullnetit te paleve, e cila mund te jete ne cdo forme ne forme verbale, me shkrim, me heshtje apo me veprime konkludente. Nga teresia e veprimeve qe ka kryer pala e paditur, krijohet bindja se kjo pale ka qene dakord per ekzistencen e kesaj marredhenie juridike. Sa me siper parashikohet dhe nga neni 80 i K.Civil, ne te cilin thuhet se: "Veprimet juridike mund te behen me shkrese, me goje dhe me cdo shfaqje tjeter te padyshimte te vullnetit". Me shprehjen "shfaqje tjeter e padyshimte e vullnetit", do te kuptojme pikerisht, shfaqen e vullnetit me veprime konkludente ose me heshtje. Nje gje e tille parashikohet qarte dhe ne nenet 669 dhe 676 te K.Civil, te cilat nuk bejne gje tjeter, vecse plotesojne kuptimin e nenit 80 te K.Civil.

Ne Kodin Civil konsiderohet si cast i lidhjes se kontrates momenti kur propozuesit i ka mberritur pergjigja per pranimin e propozimit nga pala tjeter, (nenin 665 i K.Civil). Fakti qe pala paditese ka vazhduar proceduren e realizimit te spotit (sic tregohet ne piken 2 te ketyre parashitimeve) duke u paraqitur edhe ne xhirimet e spotit, si edhe qendrimi i saj i vetedijshem per shfaqjen ne spot, i pohuar bashkepunotoreve prezent ne kohen e xhirimeve. Po ashtu marrja pjese ne nje spot te dyte gjate vitit 2017, vit kur trasmetohej Spoti i \*\*\* ne TV dhe billboardet, tregon qarte qe ajo ka pranuar kete propozim dhe ka qene dakord me vazhdimin e ketij bashkepunimi me paditesin \*\*\*, dhe kushtet e ketij veprimi juridik perfshinin edhe shfaqjen e saj ne spot, ne te kundert do te kishte nderprere kryerjen e xhirimeve ose nuk do te ishte paraqitur me.

Konsensusi per te lidhur nje kontrate verbale eshte dhene nga prindrit e paditeses. Kjo u pohua qartesisht ne deshmime e dy deshmitareve Znj. \*\*\* dhe z. \*\*\*. Po ashtu edhe komunikimet telefonike te kryera nga telefoni i kostumografes \*\*\*, te certifikuara nga ekspertiza e gjykates, konfirmuan prapsimet e te paditurit se dakordesia per t'u shfaqur ne spotin televiziv objekt gjykimi.

Te drejtat ekskluzive pasurore per transmetimin e spotit i takojne perfaqesuesit te interpretuesve qe eshte paditesi, pasi ai ploteson kushtin e nenit 109/3 te Ligjit 35/2016 "Per te Drejtat e Autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me to". Paditesi ne cilesine e perfaqesuesit te interpretuesve ka kontrate me shkrim se paku me shumicen e prej 22 interpretuesve ne kete spot. Keto kontrata jane paraqitur si prova dhe jane pjese e dosjes gjyqesore, ne te cilat interpretuesit ia japin te drejten e perfaqesimit per veprimet e parashikuara ne piken 1 te nentit 109 te ketij ligji, per efekt te te drejtave pasurore qe kerkohen ne padi.

Paditesja ngaterron qellimisht shperblimin e demit te pretenduar, dhe shperblimin e qe perfitonte paditesja nga te drejtat ekskluzive pasurore dhe jo pasurore te interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit (sic pretendon se eshte paditesja) qe garantohen nga Ligji 35/2016 "Per te Drejtat e Autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me to". Ne fakt, nga gjithe te drejtat qe garanton neni 108 dhe 109 i Ligjit per interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit, asnje prej tyre nuk permendet konkretisht ne padi. Pyetja eshte se cila prej ketyre te drejtave te parashikuara ketu i eshte shkelur paditeses? Nga ana tjeter keto te drejta paditesja pa i specifikuar i lidh me demin e shkaktuar nga perdorimi i interpretimit te saj pa konsensus apo pa lidhur nje kontrate. Ne fakt, te drejtat e parashikuara ne ligj jane dhe duhet te ishin ndare nga demit qe

vjen nga perdorimi i pautorizuar i interpretimit.

Faktikisht interpretimi i saj ne spotin objekt gjykimit eshte autorizuar plotesisht nga paditesja dhe ketu nuk ka dem. Per sa i perket, te drejtave ekonomike te shfaqjes se materialit audioviziv (spotit) sipas parashikimit te nenit 109/6 te ligj it nr. 35/2016, duke qene perpara nje vepre kolektive ku edhe interpretimi ne kete reklame eshte bere ne menyre kolektive, atehere edhe te drejtat ekonomike ne fjale u perkasin gjithë stafit te realizuesve te tij.

Paditesja ka qene vetem njera prej figuranteve te spotit. Ne realizimin e spotit kane marre pjese nje numer i madh krijuesish dhe figurantesh. Per paditesen e drejta e saj ekskluzive ekonomike perfaqesohet nga vlera e kontrates se saj të sherbimit me \*\*\*, vlere kjo standarde prej \*\*\*- \*\*\*Lekesh, qe eshte refuzuar nga paditesja, nepermjet perfaqesuesve te saj ligjor.

Paditesja i pretendon keto te drejta ekskluzive ekonomike qe ka perfituar i padituri nga spoti, por nuk tregon se sa eshte realisht vlera qe i padituri ka perituar nga keto te drejta si producent i spotit, sa eshte vlera e te gjithë spotit, dhe sa pjese e kesaj vlere pretendon paditesja se i takojne asaj si shperblim per paraqitjen qe ka bere ne kete spot. Faktikisht nga kontrata qe i padituri ka me palen e trete Altelecom e gjithë vlera e kontrates eshte \*\*\* (kater million e peseqind e teteqind e shtatedhjte e nenete) leke. Kjo vlere eshte ndare midis komponenteve te ndryshem te prodhuesve dhe figuranteve te ketij spoti

Vlera e gjithë figuranteve te tjere, \*\*\* persona me kontrate, eshte \*\*\* leke. Disa prej ketyre figuranteve jane persona te rritur, qe kane punuar disa dite pune, ndersa \*\*\* ka qene e pranishme vetem per 2 ore-pune. Nga kjo perlllogaritje, ne rastin me te mire vlera qe i takon paditeses eshte ajo qe i eshte ofruar gjithë figuranteve te tjere ne kete spot per aq sekonda sa shfaqet ajo, pra midis \*\*\*- \*\*\*lekeve. Kurse kerkimi prej \*\*\* lekesh qe behet ne padi eshte absurd dhe nuk bazohet as ne ligj ose ne praktiken e mire te tregut ne Shqiperi per figurantet e spoteve te tilla televizive.

Per sa i te drejtave jopasurore te parashikuara ne nenin 108 te te njejtij ligj, ato nuk jane kerkuar ndonjehere nga paditesja dhe nuk mund te jene pjese e ketij gjykimi. Por paditesja, edhe pse nuk ka kerkuar ndonje nga te drejtat pasurore te parashikuara nga ligji nr. 35/2016, ajo pretendon nje dem jopasuror per vete per shkak te perdorimit te "interpretimit prove" te paaautorizuar per perdorim sipas saj. Duhet thene se ky dem jopasuror, ne menyren se si arsyetohet ne padi, nuk lidhet me te drejtat jopasurore qe parashikon neni 108 i ligjit nr. 35/2016.

Per te vertetuar demin jopasuror paditesja bazohet ne "aktin vleresimin psikologjik", i cili ne vetvete perfaqeson nje akt te njeanshem dhe aspak profesional. Nga ana jone provohet plotesisht se paditesja ka shkuar me deshire dhe madje me entuziazem ne xhirimet e spotit, madje ka kembengulur "te dale perseri ne TV". Jo vetem kaq, por sjellja e saj dhe e prinderve te saj kur kane marre pjese edhe ne spotin e dyte te te paditurit, pas disa muajsh qe ishte hedhur ne treg spoti i pare (reklama e \*\*\*), tregon qarte se asnje lekundje emocionale nuk ka patur paditesja e mitur, apo familajaret e saj. Perkundrazi "dalja ne TV" i ka gezuar te gjithë ata. Madje psikologia private e pales paditese shkon deri ne gjykimin e cfare eshte e drejte dhe c'fare eshte e padrejte per paditesen duke u shprehur ne aktin e saj se "lekundja emocionale i eshte shkaktuar te mitures per shkak te padrejtesise qe i eshte bere ... " (fq. 11, Interpretime). Ne fakt ky eshte nje gjykim qe del jashte misionit te saj si psikologe, profesion te cilin zj. \*\*\* pretendon se e ushtron ne formen e psikologes klinike. Edhe nese psikologia ka konstatuar pagjumesi, stres kronik, gjendje ankthi tek i ati i paditeses, ato nuk mund te jete pasoje apo efekte qe lidhen me daljen e vajzes se tij ne nje reklame. Provohet qe te dy prinderit kane patur dijeni te plate per spotin dhe pritshmeri te qarte qe vajza e tyre do te ishte pjese e nje spoti televiziv.

Nga provat dhe faktet e sjella nga i padituri del qarte se pretendimi i padise perben nje abuzim me te drejten e padise, pasi prinderit e paditeses kane qene gjithmone te vetedijshem per lejimin e perdorimit te interpretimit te vajzes se tyre ne nje spot televiziv, madje kane



gene entuziast dhe kane kerkuar vete me kembengulje te marrin pjese ne te. Kurse, akti i psikologes eshte nje akt i njeanshem i cili nuk bazohet ne faktet dhe sjelljet reale te pales paditese dhe familareve te saj, nuk merr ne konsiderate sjelljet e tyre sic eshte paraqitja me vullnetin e tyre ne dy spotet e paditesit, moskundershtimi per nje kohe te gjate te spotit i cili transmetohej ne TV prej muajsh, si dhe dijenine e prinderve te vajzes per procedurat dhe fazat e relaizimit te spotit objekt gjykimi, si dhe theniet e deshmitareve qe kane komunikuar me paditesen dhe prinderit e saj. Si i tille, ky akt ekspertimi privat nuk duhet konsideruar si prove e vlefshme nga gjykata pasi vjen ne kundershtim me faktet dhe provat qe sillen nga ne ne kete gjykim.

28. Si perfundim, nga faktet dhe provat e permendura nga ne melart, por edhe prova te tjera qe u moren gjate shqyrtimit te kesaj padie, sic jane provat me deshmitar, rezulton se pretendimi i padise mbi perdorimin i paautorizuar i interpetimit te paditeses nuk qendron, pasi paditesja e ka shprehur vullnetin e saj per te qene pjese e spotit/reklames. Shprehja e vullnetit te paleve mund te jete ne cdo forme, ne forme verbale, me shkrim, me heshtje apo me veprime konkludente. Nga teresia e veprimeve qe ka kryer pala e paditur, krijohet qartesisht bindja se kjo pale ka qene dakord per ekzistencen e kesaj marredhenie juridike, madje ka qene entuziaste per te. Kështu që padiaduhet të rrëzohet si e pabazuar në ligj dhe në prova.

#### Vlerësimi i gjykatës

Gjykata cmon se në rastin në gjykim rrezultoi se pala paditese \*\*\*, në nëntor 2016, ka filluar procesin e provave (casting) \*\*\* për një spot për klientin \*\*\* në datën 14.12.2016. Pas kalimit me sukses të provave dhe përzgjedhjes, paditësja ka kryer me sukses xhirimet e spotit. Në provat përzgjedhëse dhe xhirimet paditësja \*\*\* është shoqëruar nga gjyshja e saj \*\*\*. Pavarësisht se keto xhirime jane kryer me sukses, dhe spoti i \*\*\* ka dale ne transmetim ne Janar te 2017, nuk rezulton qe pala e paditur, shoqeria \*\*\* sh.p.k, ne cilesine e prodhuesit te spotit, ti kete ofruar per nenshkrim paditeses kontraten e prodhimit; kontrate kjo ne te cilen do te percaktoheshin te drejtat pasurore qe i kalonin prodhuesit te spotit, afati i kalimit te ketyre te drejtave, shperblimi perkates edhe element te tjere te rendesishem te cilet do te definonin marredhenien juridike midis paleve ndergjvqese. Po kështu foto të këtij spoti janë përdorur edhe në reklama dhe billborde të ndryshme, rrjete sociale te tilla si facebook etj.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësja se bashku me gjyshen e saj kane marre pjese edhe në nje spot të xhiruar në 20.06.2017 ku \*\*\*, gjyshja e \*\*\* bashke me vete \*\*\* kane ardhur si figurante ne nje spot tjetër te prodhuar nga \*\*\*. Pikerisht, ne 20 Qershor 2017 \*\*\* kryen xhirime te spotit te nje birre qe tregtohet ne tregun shqiptar. Xhirimet janë kryer ne ambientet e \*\*\*, ne \*\*\*.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se pjesëmarrja në spot e paditësës \*\*\*, nuk është shoqëruar në nënshkrimin e një kontarte, ne te cilen do te percaktoheshin te drejtat pasurore qe i kalonin prodhuesit te spotit, afati i kalimit te ketyre te drejtave, shperblimi perkates edhe element te tjere te rendesishem te cilet do te definonin marredhenien juridike midis paleve ndergjvqese. Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se paditësja \*\*\* në kohën e kryerjes së spotit ka qenë e mitur nën moshën 14 vjec. Në bazë të nenit 7 të K.Civil ajo ka pasur zotësi të pjesshme për të vepruar. Konform përmbajtjes së nenit 8 të K.Civil, i mituri, që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjec është i pazoti për të vepruar. Ai mund të kryejë veprime juridike që i përshtaten moshës së tij dhe që përmbushen aty për aty, si dhe veprime juridike që i sjellin dobi pa asnjë kundërshtim. Veprimet e tjera juridike i kryen në emër të tij përfaqësuesi ligjor. Në bazë të nenit 232/1 të K.Familjes, prindërit përfaqësojnë fëmijën etyre të mitutr që nuk ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjec në të gjitha veprimet juridike, me përjashtim të atyre që, sipas ligjit, i mituri mund ti kryejë vetë. Gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk u provua që

prindërit e paditëses të kenë përfaqësuar paditësen gjatë pjesëmarrjes në spot. Ajo siç rezultoi e provuar është shoqëruar gjatë provave dhe xhirimeve nga gjyshja e saj \*\*\*, e cila nuk është përfaqësuesja e saj ligjore. Gjatë shqyrtimi gjyqësor nuk u provua as që prindërit në cilësinë e përfaqësuesve të saj ligjorë të kenë nënshkruar një kontratë të shkruar ku të autorizojnë pjesëmarrjen e paditëses në spot dhe në këtë cilësi të kenë dhënë pëlqimin për përdorimin e të drejtave që lindin nga kjo pjesëmarrje.

Në bazë të nenit 48/2 të ligjit 35/2016 “Për të drejtën e autorit”, që përcakton se: “2. Kontrata e së drejtës së autorit, përveç përdorimit të veprave në gazeta dhe botime të tjera periodike, është e vlefshme vetëm në formë të shkruar dhe parashikon: përshkrimin e veprës, të drejtat dhe detyrimet e mbajtësit që i fiton këto të drejta; formën ekskluzive/joekskluzive; masën/mënyrën e përdorimit të veprës që mbulohet nga ajo; afatin e vlefshmërisë; territorin në të cilin zbatohet; vlerën e shpërblimit ose bazën për përcaktimin e kësaj vlere për përdorimin e veprës; kushtet dhe afatet e pagesës së shpërblimit” dhe nenit 3/2 të titulluar “Kuptimi i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to”, që përcakton se: “2. Të drejtat e interpretuesve dhe/ose ekzekutuesve i përkasin, nga natyra, personit fizik, i cili ka kryer interpretimin dhe/ose ekzekutimin e krijimit letrar ose artistik ose shprehive të folklorit”, kontrata e të drejtave të autorit që të jetë e vlefshme duhet të jetë në formë të shkruar.

Duke pasur parasysh faktin që kontrata e të drejtës së autorit duhet të bëhet me shkresë për efekt vlefshmërie, si dhe faktin e sipërcituar që paditësja në kryerjen e provave dhe xhirimeve është shoqëruar nga gjyshja e saj, pa pasur një kontratë të nënshkruar nga përfaqësuesit e saj ligjorë, prindërit, gjykata konkludon se në rastin në gjykim ndërmjet palëve nuk është nënshkruar një kontratë në formë të shkruar ndërmjet palëve ndërgjyqëse, që të përcaktojë të drejtat dhe detyrimet respektive. Për shkak të specifikave të sipërcituar për vlefshmërinë e saj, ajo nuk mund të lidhet me veprime konkludente, për shkak se ligjvënësi ka përcaktuar dhe kërkon respektim të formës, për vlefshmërinë e saj. Ekzistenca e saj për shkak të këtyre specifikimeve nuk mund të provohet as me dëshmitarët e sjellë nga pala e paditur në gjykim \*\*\*dhe \*\*\*.

Gjykata çmon se në rastin në gjykim paditësja \*\*\* ka marrë pjesë në spotin e \*\*\* në rolin e interpretimit dhe/ose ekzekutimit në të njëjtën shfaqje në mënyrë kolektive. Në bazë të përcaktimit të dhënë në pikën 7 të nenit 109 të ligjit 35/2016 “7. Për çdo të drejtë ekonomike, e cila është kaluar sipas pikës 6, të këtij neni, interpretuesit dhe/ose ekzekutuesit do të gëzojnë të drejtën për përfitimin e shpërblimit të drejtë nga prodhuesi (producenti) i filmit”. Pikërisht mungesa e autorizimit nga ana e prindërve për pjesëmarrjen e paditëses në spot, passjell cënimin e të drejtave ekskluzive të paditëses, të tilla si e drejta për shpërndarjen e interpretimit/ ekzekutimit, e drejta për ta dhënë me qira ose huadhenie etj... Këto të drejta sipas nenit 109 të ligjit 36/2015 janë të drejta që i përkasin ekskluzivisht palës paditëse në cilësinë e interpretueses/ekzekutueses dhe i kalojnë prodhuesit vetëm përmes një kontrate shkresore prodhimi.

Duke pasur parasysh sa më sipër gjykata çmon se në rastin në gjykim, nuk kemi një kontratë të shkruar. Detyrimi ligjor për të formalizuar marrëdhënien juridike ndërmjet palëve, nëpërmjet një kontrate prodhimi/punesimi/porosie etj, i takon të paditurit si personi juridik i cili ka prodhuar spotin (nenet 674 e 675 të K.C). Për rrjedhojë në rastin në gjykim kemi të bëjmë me një veprim juridik të pavlefshëm. Në bazë të përcaktimit të dhënë në fjalinë e fundit të nenit 108 të K.Civil, pala që ka zotësi për të vepruar detyrohet t’i shpërblejë të miturit dëmin që ky ka pësuar për shkak se veprimi juridik konstatohet ose shpallet i pavlefshëm. Në korelacion me këtë përcaktim në nenin 172 të ligjit 35/2016 është parashikuar “Shpërblimi për dëmin” duke përcaktuar se: “1. Për shkeljet, sipas këtij ligji, parashikimet e këtij ligji do të jenë të zbatueshme në përputhje me rregullat e legjislacionit në fuqi që rregullojnë shkaktimin e dëmit.

2. Kundërvajtësi do t'i paguajë mbajtësit të së drejtës dëmet në shumën që do të përcaktohet sipas rregullave në fuqi për kompensimin/shpërblimin e dëmit ose me shumën, për të cilën është rënë dakord mes palëve, ose sipas shpërblimit për përdorimin legjitim të asaj vepre.

3. Në qoftë se një e drejtë, sipas këtij ligji, është shkelur qëllimisht ose nga pakujdesia e rëndë, titullari i së drejtës mund të kërkojë pagimin, për të cilin është rënë dakord ndërmjet tyre, ose shpërblimin përkatës për këtë përdorim nga personi, i cili ka shkelur të drejtën e tij, pavarësisht nëse ai ka pësuar dëmtime për shkak të kësaj shkeljeje.

4. Në kërkesën për përcaktimin e dëmeve dhe përcaktimin e shumës së tyre, gjykata mban parasysh të gjitha rrethanat e rastit dhe, në veçanti, shkallën e dëmit të shkelësit, shumën për të cilën është rënë dakord ose shpërblimin nga përdorimi legjitim i veprës”.

Ne veshtrim të nenit 172/3 të ligjit 35/2016, pala paditese ka të drejtën të kërkojë nga pala e paditur - ose - shpërblimin përkatës të dëmit për përdorim të paautorizuar të interpretimit/ekzekutimit - ose - shumën e dakorduar midis palëve - ose - shpërblimin për përdorim legjitim të asaj vepre. Duke pasur në konsideratë përmbajtjen e kësaj dispozite por edhe rrethanat konkrete të faktit si me sipër cituar, pala paditese, ne disponim të së drejtës së saj, kërkon nga pala e paditur të shpërblejë dëmin përkatës për përdorim të paautorizuar të interpretimit/ekzekutimit. Duke pasur parasysh sa më sipër gjykata cmon se në rastin në gjykim i padituri \*\*\* duhet të dëmshpërblejë paditësen \*\*\* për dëmin që i është shkaktuar asaj nga pjesëmarrja në Spotin e \*\*\*. Në përcaktimin e dëmit gjykata duke u bazuar në nenet 109, 49 dhe 172 të ligjit 35/2016 cmon që paditësj \*\*\* duhet të dëmshpërblehet për dëmin që i është shkaktuar nga i padituri \*\*\*.

Shpërblimi i dëmit përcaktohet në nenet 608 e vijues të K.Civil. Elementët konstitues të këtij instituti janë: 1) Fakti i paligjshëm 2) Faji 3) Demi dhe 4) Lidhja shkakësore.

Fakti i paligjshëm rezulton teresisht e provuar se pala e paditur e ka shpërndarë interpretimin e pales paditese pa pasur një autorizim. Po ashtu, nuk ka asnjë veprim juridik nepermjet të cilit pala paditese të ketë kaluar pales së paditur të drejtat pasurore ekskluzive, sic është e drejta për të shpërndarë veprën, për ta dhënë me qira apo për ta përdorur etj. Madje pala paditese nuk rezulton as të jetë shpërbleyer nga pala e paditur për shfrytëzimin e interpretimit të saj.

Kryerja e veprimeve të tilla parashikohet edhe si kundërvajtje administrative edhe nga germa gj) të nenit 179 të ligjit 35/2016, për të cilat pika 2 dhe 3 e këtij neni parashikon një gjobe nga 100.000 deri në 500.000 leke. Ndërsa pika 6 e nenit 179 parashikon se ndaj personit juridik i cili kryen shkeljet mund të ndermerret masa e ndalimit të kryerjes së aktiviteteve tregtare për një periudhë prej 1 viti.

Përsa i përket fajit, theksojmë se veprimet e sipërcituara janë kryer me faj (në formën e pakujdesisë së rëndë) sepse në rastin në gjykim pala e paditur ka kryer një veprim juridik me një të mitur nën moshën 14 vjeç, e cila është plotësisht e pazonja për të vepruar. Si rezultat i veprimeve të kundërligjshme ka ardhur edhe pasoja cënimi i të drejtave të paditëses të njohura nga ligji 35/2016 “Për të drejtën e autorit”. Vlen të theksohet se në rastin e marrëdhënieve juridike civile, fajësia si element subjektiv prezumohet nga pikpamja ligjore me vertetimin e ekzistencës së elementit objektiv, atë të faktit të kundërligjshëm. Për këtë shkak, detyrimi për të provuar ekzistencën e mungesës së fajit i përket në çdo rast pales së paditur, e cila në çështjen objekt gjykimi nuk paraqet asnjë mjet provues nepermjet të cilit të vertetojë se demi i ardhur është pa fajin e saj.

Në bazë të kësaj përgjegjësie, e njohur si përgjegjësia akuifane (lex Aquilia de damno), cilido që shkel të drejtat dhe interesat e ligjshme të një tjetri detyrohet t'a dëmshpërblejë atë.

Nepermjet dëmshpërblimit synohet pikerisht rivendosja e plote e të dëmtuarit (restitutio in integrum) në gjendjen e mëparshme (status quo ante), në të cilën ai do të gjendej nëse nuk ndodhte fakti i paligjshëm, jo vetëm në kuptimin e ngushtë ekonomik, por edhe në të mirat jopasurore që mishërojnë vlerat e njeriut.

Duke pasur parasysh sa më sipër gjykata konkludon se në rastin në gjykim pala paditëse \*\*\*

duhet të dëmshpërblehet nga pala e paditur \*\*\* për dëmin që i është shkaktuar. Fakti i shpërblimit të dëmit të shkaktuar paditëses është pranuar edhe nga i padituri i cili i ka ofruar si shpërblim shumë Euro.

Në përcaktimi e vlerës së dëmit të shkaktuar paditëses gjykata ka porsysh shkallën e dëmit që i është shkaktuar paditëses, faktin që ajo ka qenë e mitur, gjerësinë e shpërndarjes së spotit në TV me shikueshmeri shume te larte (Klan, Top Channel etj ...), rrjete sociale te tilla si facebook etj... Gjithashtu, interpretimi i paditëses është shfaqur edhe në formën e një imazhi (fotografie) në billboarda të ndryshme dhe në vecanti në aeroportin e Rinasit (vend i cili ka një shikueshmeri shume te larte nga publiku) dhe Portin e Durrësit etj. Në përcaktimin e vlerës së dëmit gjykat ka porsysh gjithashtu vlerën e spotit që është \*\*\* leke, ndërkohë që pagesa e \*\*\* persona me kontrate, është \*\*\* leke, shumë kjo shume perben vetem \*\*\*% te shumes totale te perfituar nga shoqeria \*\*\* sh.p.k per realizmin e spotit. Ndersa shuma e perfituar nga secili interpretues perben vetem \*\*\*% te shumes totale te perfituar nga shoqeria \*\*\* sh.p.k.

Duke pasur porsysh sa më sipër gjykata cmon që shpërblimi i plotë i dëmit të paditëses duhet të jetë në vlerën \*\*\* lekë.

Nga sa argumentuam më sipër gjykata ëmon që padia duhet të pranohet pjesërisht si e bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata duke u bazuar në nenet 306-310 të K.Pr.Civile.

V E N D O S I:

Pranimin e pjesshem te kerkese padise.

Konstaimi I cenimit nga pala e paditur Shoqeria “\*\*\*\*” sh.p.k te se drejtes pasurore dhe jopasurore te paditëses \*\*\*, ne rolin e interpretueses ne veper (reklame), per personin e trete \*\*\*.

Detyrimin e pales se paditur Shoqeria “\*\*\*\*” sh.p.k, qe te shperbleje paditësen \*\*\*, per interpretimin ne vepren (reklame), per ne kushtet e perfitimit nga te drejtt ekskluzive pasurore dhe jopasurore te saj ne vleren \*\*\* leke.

Rrezimin e kerkese padise per pjesen tjeter.

Ky vendim është I ekzekutueshem nga permbaruesi gjyqesore

Shpenzimet gjyqësore në raport me pjesen e pranuar te padise I ngarkohen te paditurit.

Detyrimin e paditëses \*\*\*, që të paguajë në favor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor shpenzimet e kreyera për njoftimin e palëve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë sot me datë 21.09.2020

SEKRETARE  
GJYQTAR

SUELA ARAPI (MURATAJ)  
SHKURTI

ALTIN